



Prishtinë, 23 qershor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1256_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 7 nënparagrafet 7.2, Nenit 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, Nenit 26 dhe Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Vendimin e Rregullatorit V_1223_2020 për aprovim të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Dispozitave të Nenit 4/1 të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Shkresës së KEDS nr. 49 të datës 22.06.2020 për propozimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

Në seancën e mbajtur me datë 23 qershor 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** emërimi i Avni Alidemaj si Zyrtari i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes i bërë nga Bordi Ekzekutiv i OSSH (KEDS SH.A).

Arsyetim

- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 12 shkurt 2020 ka nxjerr Vendimin V_1223_2020 me të cilin ka aprovuar Programin e Pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.
- o Në përputhje me Nenin 4/1 të Programit të Pajtueshmërisë, ZRRE me datë 22.06.2020 ka pranuar shkresën nga OSSH me të cilën i propozojnë Bordit të ZRRE-së që ta miratoj propozimin për emërimin e z. Avni Alidemaj në detyrën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë i bërë nga Bordi i OSSH.
- o Rregullatori ka shqyrtuar shkresën e KEDS për emërimin e Zyrtarit të Pajtueshmërisë si dhe vlerësimin të biografisë së z. Avni Alidemaj e bashkangjitur shkresës së KEDS, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.




- I. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- II. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KEDS SH.A, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar